

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Përgjegjës Sektori, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (Kategoria III-a/1).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Vendimit Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2022”; Urdhër Nr.6667/1, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për për zgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ka për detyrë si më poshtë:

- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse varet nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, merr detyra dhe përgjegjësi perpara tij për veprimtarinë e sektorit si dhe kryen çdo detyrë tjetër brënda fushes së tij të përgjegjësiive.
- Drejton, mbikqyrë dhe ndjek të gjithë punën profesionale të sektorit, dhe përgjigjet për cilësinë e saj në sektorin që drejton .
- Harton plan pune dhe cakton detyrat e përgjithshme dhe detyra të veçanta për çdo punonjës të sektorit, ndjek dhe raporton zbatimin e tyre dhe përgjigjet për veprimtarinë e punonjësve.
- Menaxhon burimet njerëzore të sektorit dhe ndan detyrat dhe përgjegjësitë ndërmjet specialistëve të sektorit.

- Caktohet me urdhër të Kryeinspektorit në grupe të ndryshme pune, komisione vlersim të ofertave, komisione të tjera të ndryshme sipas rasti.
- Raporton tek Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në lidhje me realizimin ose jo të detyrave/planit të punës duke dhënë shpjegimet përkatëse si dhe duke nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse në rast mosrealizimi.
- Kryen dhe detyra të tjera të veçanta të parashikuara ose jo në këtë përshkrim pune, por të ngarkuara nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetës.

Dokumentat që aplikanti për Përgjegjes në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 16.05.2022 **ora** 16.30